



# **NJË SHIKIM MBI HISTORINË E SË NESËRMES**

*Dr. 'Ali Shari'ati*

Natyrisht, miqtë e mi, ju s' duhet të prisni të dëgjoni tani një ligjëratë të thelluar dhe të mirëpregatitur sepse nuk kam patur më shumë se një apo dy orë kohë për t'u menduar, por kam folur (edhe) më parë mbi këtë temë në universitet dhe shpresoj se do jem në gjendje të rikujtoj pikat që kam përmendur aty e t'jua paraqes ato juve sonte.

Tibor Mende, një studiues i famshëm hungarezo-francez, njëri prej mendimtarëve të shquar të së sotmes në të kuptuarit e Botës së Tretë - si Afrika, Azia dhe Amerika Jugore, ka shkruar një libër të titulluar "Një Shikim Mbi Historinë e së Nesërmes". Nuk do diskutoj atë që thonte ai, apo këtë libër. Në vend të kësaj, dua ta paraqes këtë shprehje të cilën e dëgjova për herë të parë nga ky njeri - dhe ç' shprehje e mrekullueshme që është! Disa fjalë kanë të njëjtën të drejtë për të jetuar posi një person (siç thonte André Gide), dhe nëse nuk e kanë të drejtën për të jetuar, ato kanë të drejtën të zhvillojnë një mendim, sepse ndodh shpesh që brenda nesh ka një koncept për të cilin s'jemi të vetëdijshëm. Kur dëgjojmë një shprehje të ngjashme me të, kjo shprehje e konceptit bëhet në vetvete një burim shfaqjeje së një ideje dhe lindjes së një mendimi të brendshëm.

Shprehja "Historia e së Nesërmes" është një shprehje e re dhe revolucionare. Historia, në përmbajtje dhe shpirt, ka pasqyruar gjithmonë të kaluarën. Histori d.t.th e kaluara. Meqë shprehja "Një Shikim Mbi Historinë e së Nesërmes" është revolucionare, bëhet e qartë se bota është ndërgjegjësuar për faktin se sot duhet shkruar historia e së nesërmes gjithashtu, ose të paktën të mendohet për historinë e së nesërmes. Ne duhet ta kemi pranuar më parë këtë mendim dhe ta shohim historinë si një shkencë të vërtetë. Historia do ketë vlerë vetëm nëse do shkruajmë edhe atë të së nesërmes. N.q.s historia nuk na ndihmon të njohim të nesërmen ose të paktën njeriun e së sotmes apo njeriun që do shfaqet në të ardhmen, atëherë ajo do jetë e padobishme, sepse të gjitha shkencat duhet së paku të jenë ndihmëdhënëse në të kuptuarit e qenieve njerëzore, jetës së njerëzve të së ardhmes dhe idealeve të qenieve njerëzore të së sotmes dhe së nesërmes. Të kuptuarit e njeriut në të kaluarën duhet të jetë pikënisje që të kuptojmë veten dhe të ardhmen. Dua t' i hedh një sy historisë të së nesërmes, jo siç bëri Tibor Mende, por sipas asaj që besoj vetë. Ju kërktoj ndjesë nëse toni im është ai i një mësuesi e jo i një ligjëruesi, sepse profesioni im është ai i mësuesit. Për fat të mirë, fytyrat që shoh këtu janë kryesisht ato të studentëve universitarë që janë të njohur me tonin dhe fjalët e mia.

Me qëllim që të kuptoni çfarë kam për të thënë, dua që të përfytyroni një kon. Mbajeni këtë kon në mendje deri në fund të ligjëratës sepse kjo është platforma nga e cila do flas. Ky kon përbën sistemin e referimit të mendimeve, gjykimeve dhe ndijimeve tona. Në çdo qytetërim, shoqëri dhe epokë, historia i shfaq njerëzit e së kaluarës jo si një zinxhir i ndërprerë, por në formën e hallkave që pasojnë njëra-tjetrën - ja se ç' do të thotë histori. Njerëzimi, që nga fillimi deri tani, ka kaluar 3,4,5,10 apo, sipas Tibor Mendes, 27 periudha. Çdo stad, si një gjë jetuese, e qenë, ka një shpirt, mendime dhe prirje të veçanta. Ne sot dijmë se çdo periudhë ka gjendje specifike, veçanti, mendime, anime dhe pikësynime që periudha paraprirëse nuk i kishte. Kështu, për të kuptuarit e çdo stadi nevojitet ky kon dhe çdo periudhë mund të ndahet saktësisht sipas këtij modeli. Me anë të një studimi të kujdesshëm, ne mund të parashikojmë të ardhmen.

Si shembull, mund të kthehemi tre shekuj prapa dhe ta zbatojmë këtë model mbi Mesjetën në Evropë. Baza e këtij koni, që ka sipërfaqen më të gjerë, zihet nga shumica e njerëzve të shoqërisë - njerëzit e masës. Ky kon ka pjesën e poshtme dhe të sipërme e siç e shihni, pjesa e poshtme e tij është më e madhe se e sipërmeja. Masa e njerëzve në

çdo shoqëri, nga pikëpamja e nivelit dhe vëllimit, vendosen në këtë pjesë të poshtme. Intelektualët, dijetarët dhe mendimtarët e çdo epoke gjenden në pjesën e lartë të konit. Ky grup quhet grupi i intelektualëve. Kjo d.t.th grupi, puna e të cilit në përgjithësi vërvitet rreth mendimit, në vend të një organi apo gjymtyri të trupit të industrisë. Shkrimtarët, 'ulematë, dijetarët, poetët, mendimtarët dhe filosofët ndodhen mes grupit së pjesës së sipërme të konit. Në çdo shoqëri, njerëzit e thjeshtë gjenden në bazën e konit dhe intelektualët në pjesën e sipërme të tij. Kjo është e vërtetë edhe në shoqëritë primitive. Kur ne e zbatojmë këtë model koni te shoqëritë primitive, masat, fiset dhe njerëzit e thjeshtë përbëjnë bazën e konit dhe ata kanë një grup 'intelektualësh' që janë mjekët popullorë, pleqtë, fisnikët dhe personat që, gjithsesi, u prijnë njerëzve.

Epoka të ndryshme kanë kaluar. Ky kon zbatohet për të gjitha ato. Kam vënë re se sa më moderne të jetë era, aq më shumë zvogëlohet baza e konit - d.m.th ajo e njerëzve të thjeshtë - në dobi të nivelit të intelektualëve. Pra, vëllimi i masës zvogëlohet dhe ky vëllim i shtohet atij të klasës intelektuale. Kjo d.t.th që numri i intelektualëve në çdo periudhë është më i madh se në të mëparshmet, sepse kultura bëhet më e përhapur, idetë bëhen më të hapura dhe shkenca e mendimet bëhen më mbizotërues, duke shkaktuar që njerëzit të ngriten në nivelin e intelektualit. Nuk ka një kufi ndërmjet klasës së masave dhe asaj të intelektualit. Duke u ngjitur lart nëpër kon, njerëzit e thjeshtë u afrohen më tepër intelektualëve dhe në nivelin më të lartë të konit, ndodhen pikërisht intelektualët. Duke zbritur, intelektualët u afrohen masave të popullit, ndërsa duke u ngjitur ata u largohen njerëzve të thjeshtë, gjersa arrihet kulmi, ku dijetarët dhe intelektualët marrin trajtën e të adhuruarve për mendjendriturit e çdo epoke dhe shërbejnë si një burim për mendimin intelektual në çdo periudhë. P.sh sot, tipa si Jean-Paul Sartre, Bertrand Russell dhe Laurent Schwartz janë në pjesën e sipërme të konit, në klasën intelektuale të tij dhe një njeri me shkollë të mesme ndodhet në pjesën e poshtme të këtij grupi, pranë masës. Kjo është hyrja për atë që kam për të thënë. Do të vazhdoj prej këtu.

Do e zbatojmë këtë model të konit mbi Mesjetën. Kush ishin njerëzit e thjeshtë në Mesjetë? Njerëzit që në Francë, Itali dhe Angli shkonin në kishë. Aty futen urdhërat e priftërinjve dhe urdhërat që shkollarët zyrtarë dhanë në emër të Biblës, Pentaukut, të Jezusit dhe Zotit. Ata e pranuan dhe e praktikuan këtë. Ata ishin njerëzit e thjeshtë të Mesjetës. I njëjti tip njerëzish të thjeshtë jeton në erën e re dhe ka të njëjtat ndjenja dhe tipare. Për Krishtlindje, kur Papa shfaqet në dritaren e Shën Palit, qindramijëra të krishterë mund të shihen aty, që thërrasin aq fort kur shohin rrobat e tij të pastra dhe dekorimet, sa që zhyten në ndjenja fetare dhe emocione të forta religjioze kur rikujtojnë Mesjetën. Ndjenjat dhe mendimet e tyre janë po ato mendime të njerëzve që jetuan tre apo katër shekuj më parë gjatë Mesjetës në Itali dhe Francë. Kështu kur themi se sot është epoka e re, nënkuptojmë se ka ndodhur një ndryshim në klasën e intelektualëve të Evropës, jo në atë të njerëzve të thjeshtë. Kështu, të gjitha mendimet tona duhet të drejtohen për gjetjen e veçantive të çdo periudhe në nivelin e intelektualit.

Por ka edhe diçka tjetër dhe kjo është se në çdo epokë, përkrah njerëzve të thjeshtë në bazën e konit dhe intelektualëve në pjesën e sipërme të tij, shumë pak dhe fare rrallë ekzistojnë individë mendimet e të cilëve ndryshojnë nga dhe u kundërvihen atyre të intelektualëve dhe ideve të të shkolluarve. Ata nuk mund të futen tek njerëzit e thjeshtë. Ata janë shkrimtarë dhe gjeni të mëdhenj të njerëzimit. Ata nuk mund të vihen as në klasën e intelektualëve. Pse? Sepse lënda e asaj që kanë për të thënë nuk është ajo në të cilën besojnë intelektualët dhe në thelb, ata kanë sjellë mendime të reja në të cilat intelektualët ende nuk besojnë. Përkundrazi, ata kanë shqiptuar fjalë të reja që kanë shpërthyer si një bombë. Ç'grup janë ata? Atyre s'mund t'u jepet një klasë, ata mund të

numërohen me gishta. Mund të thuhet se ata janë gjenì. Mund të thuhet se ata janë njerëz që thonë fjalë të reja të cilat bien ndesh me atmosferën mbizotëruese të shoqërisë. Ata u kundërvihen traditave të intelektualizmit dhe metodës së shkencës e intelektit të asaj epoke. Kjo është jashtëzakonisht e rëndësishme.

Kjo temë shfaqet në fundin e Mesjetës. Njerëzit e thjeshtë janë të njëjtë me ata që jetojnë sot në Evropë. Ata i binden Kishës. Ata i binden dijetarëve të mëparshëm religjiozë të Mesjetës. Të shkolluarit që jetojnë në Evropë, u shfaqën për herë të parë (vetëm) tre shekuj më parë, pra në shek. XVII, një shekull kur klasa intelektuale u vendos në formën që ka tani. Ata që ne tani i mbajmë për intelektualë dhe të shkolluar, ata që janë formuar me një kulturë të re, janë kopje të intelektualëve që u shfaqën së pari në shek. XVII në Evropë. Edhe sot e kësaj dite, shpirtëra të tërë ushqehen prej tyre; mendojnë si ata dhe imitojnë idetë, bindjet dhe mendimet e tyre shkencore. Kështu, ata janë një shtesë tjetër për ndjekësit e të shkolluarve që u formuan në shek. XVII në Evropë dhe (të cilët) vazhdojnë të drejtojnë universitetet, shkencën dhe jetën moderne deri sot.

Kush ishin njerëzit e shkolluar dhe intelektualët e Mesjetës? Ishin priftërinjtë e Krishterë, njerëz që studionin në shkolla të përngjitura me Kishën dhe qëllimi i tyre ishte të zbulonin të vërteta fetare. Synimi i tyre ishte të ndriçonin njerëzit, t'i udhëhiqnin ata, ose dosido - t'i burgosnin njerëzit në prangat, vargonjtë, kallëpin dhe qëllimet e religjionit. Kështu, kur ky model koni zbatohet te Mesjeta, klasa intelektuale përbëhet prej priftërinjve dhe dijetarëve të fesë. Ju e dini vetë se kush ishin shkollarët në Mesjetë, por në shek. XV, XVI dhe XVII lindën njerëz dhe gjeni që u ngritën kundër të shkolluarve të Mesjetës, që kishin qenë priftërinjtë e Krishterë dhe ata sollën diçka të re, por megjithatë nuk u formua ende një klasë (e re) njerëzish.

Feja dhe shkolla e mendimit e të gjithë këtyre njerëzve ishte flakja e fesë së Krishterë apo adhurimit të Zotit, dhe ata e zëvendësuan këtë me një shkollë tjetër mendimi që përbëhej nga parimet e metodave të atyre njerëzve që u shfaqën në majën e konit gjatë shekujve XVI, XVII dhe XVIII. Ata zëvendësuan adhurimin e Zotit, që kish qenë feja e intelektualëve të Mesjetës, me adhurimin e shkencës. Ndërkohë që feja thonte se duhet pranuar ajo që ndodhet në tekstet e miratuara fetare dhe se çdogjë e papërmendur aty duhet hedhur tej, këta thonin se besonin vetëm në atë që mendonin dhe vërtetonin përmes shkencës dhe përvojës e se ata nuk e pranojnë atë që nuk ekziston - edhe pse librat fetarë dhe të shenjtë e përmendin atë - përderisa ta kenë vërtetuar këtë me anë të eksperimentit dhe kërkimit shkencor. Kështu, adhurimi i shkencës përfshiu thirrjen e parë, parullën e parë që gjeni të mëdhenj si Kepler dhe Galileo e madje të tjerë përpara tyre, shpallën; një kushtim ndaj klasës së intelektualëve të fesë së Mesjetës. Kjo klasë intelektualësh së fesë reagoi kundër njerëzve me ide të reja. Ata i dënuan, i quajtën heretikë, i dogjën; i hodhën në gjyq (gjyqi i Galileos është i famshëm). Përse? Sepse ata ishin individë që po flisnin për ide të reja të cilat kundërshtonin intelektualët dhe të shkolluarit e asaj shoqërie. Kështu, në fund të Mesjetës, ishin njerëzit e thjeshtë dhe të shkolluarit (të mësuarit e fesë, të bashkangjiturit e Kishës) e mbi ta disa individë: 10 apo 20 njerëz - gjenì që u ngritën megjithë idetë e Shkollës së mendimit të këtij grupi të Kishës. Por ata nuk ishin aq të numërt sa të krijonin një klasë në shoqëri. Ata ishin individë të rrallë.

Nëse e zbatojmë këtë model koni mbi erën pasuese, d.m.th atë të sotme (shek. XVII deri XX - kohëzgjatja e erës së re), do shohim se klasa e njerëzve të thjeshtë s'ka ndryshuar, vetëm vëllimi i tyre është zvogëluar e pak janë shkolluar dhe i janë ngjitur grupit të sipërm. Nëse studiojmë këtë grup të sipërm, njerëzit e shkolluar dhe

intelektualët e erës së re që pasoi Mesjetën, (do vërejmë se) këta thonë të njëjtat gjëra që ata gjeni, ata individë të rrallë thanë në shek. XVI; gjëra, të cilave intelektualët e asaj ere nuk ia vunë veshin. Kështu, ka gjithmonë gjenit në majë të konit në shoqëri, të cilët qendrojnë mbi klasën e shkolluar, të cilët shprehin ide të reja që kundërshtojnë idetë e pranishme të klasës intelektuale dhe pastaj, në një mënyrë deterministe, në erën pasuese, fjalët e këtyre gjenive, që janë të rrallë, të huaj dhe të vetmuar në shoqëri, marrin formën e një shkollë mendimi për njerëzit e ditur të së ardhmes. Kjo d.t.th, (se) shkolla e mendimit së periudhës pasuese përbëhet nga bindje dhe një mënyrë të menduari që shprehen nga individë të rrallë të erës pararendëse. Kështu, në çdo periudhë shohim se në majë të këtij koni, ekzistojnë gjenit që i kundërvihen klasës së pranishme të formuar dhe nuk ua vënë veshin atyre. Përplasja fillon. Këta gjenit mbesin të rrallë dhe të huaj. Pak nga pak opinionet e tyre përhapen; idetë, mënyrat e tyre të të menduarit dhe madje vetë ata shndërrohen në klasën e ardhshme të formuar dhe pastaj ky grup i ri e nxjerr klasën e njerëzve të shkolluar të epokës paraprirëse jashtë nga shoqëria.

Kur i hedhim një sy Evropës sot, shikojmë se ende ka priftërinj. Ata ende kanë pushtet, por shpirti i erës së re i përket të arsimuarve që adhurojnë shkencën, jo Zotin. Kështu, nëse i zbatojmë këto parime në epokën e re dhe nëse e vështrojmë atë nga pikëpamja e fesë, verëjmë se sipas modelit sociologjik të një koni të kulturës, feja edhe kufizon edhe formon bazën e këndvështrimeve të njerëzve të thjeshtë. Shikojmë gjithashtu se ka edhe një grup që adhuron shkencën. Feja e klasës së të shkolluarve dhe intelektualëve të së sotmes është adhurimi i shkencës, e jo të paturit e ndjenjave dhe bindjeve fetare. Kështu, sipas kësaj rregulle, në përgjithësi njerëzit e mësuar të epokës sonë s'duhet të jenë fetarë! Përse? Sepse feja edhe kufizon, edhe formon bazën e bindjeve të njerëzve të thjeshtë të epokës së re, por - në ndryshim me situatën e Mesjetës kur intelektualët ishin të gjithë religjiozë - intelektualët tani adhurojnë shkencën, d.m.th, ata janë ndjekës të konceptit të adhurimit të shkencës. Ideologjia e të gjithë njerëzve të arsimuar është adhurimi i shkencave, kundrejt urdhëresave fetare dhe besimit në dogmë, udhëzimeve e parimeve të përkushtimit fetar që duhet të ndiqen pa diskutim.

Një gjë duket e sigurt dhe kjo është se feja i përket njerëzve të thjeshtë po ashtu siç i përkiste në Mesjetë. Në themel të adhurimit të kësaj klase të re dijetarësh qëndron adhurimi i shkencës dhe kur vështrojmë, shohim në fakt se, që nga shek. XVII deri tani, sa më tepër që klasa e arsimuar i afrohet bazës dhe parimit të adhurimit të shkencës, aq më shumë largohet ajo nga feja dhe në njëfarë mase, të shkolluarit e erës se re largohen nga masat.

Ndërkohë që në Mesjetë njerëzit e shkolluar kishin një bindje të përbashkët dhe flisnin me të njëjtin zë dhe ndanin një qëllim, sot të arsimuarit janë adhuruesit e shkencës dhe fetarë janë njerëzit e thjeshtë. Ky është një realitet që s'mundet kurrsesi të përligjet, të shpjegohet apo të shquhet edhe pse është kundër temperamentit dhe besimeve tona. Për shkak të kësaj, ndodh që në Europë, Amerikë, Afrikë, Amerikë Jugore dhe në Iran e vendet Aziatike, sa më shumë zgjerohet shkenca e re dhe klasa e re e sapoedukuar, siç bënte në shekujt XVII, XVIII dhe XIX, aq më shumë feja veçohet mënjandë nga maja e modelit të konit të shoqërisë duke mbetur vetëm në bazën e konit. Kështu, feja dobësohet deri në pikën sa shkatërrohet ndërsa shkenca, të adhuruarit e saj dhe besimi në vërtetësinë e shkencës zënë vendin e saj. N.q.s ky model koni zbatohet për epokën e re të sotme, siç thashë, njerëzit e thjeshtë janë ende ata të Mesjetës. Ata janë fetarë në mbarë botën. Ata kanë fenë e tyre të mëparshme. Në atë shkallë që të sapoformuarit i afrohen adhurimit të shkencës, e cila është feja e kësaj klase, ata bëhen

të tjetërsuar nga traditat dhe feja e tyre kombëtare duke u larguar prej saj. Të dhënat e grumbulluara nga njerëz që kanë studiuar sociologjinë e feve në cilindo shtet të Evropës dhe Amerikës, në Lindje apo në Perëndim, e pasqyrojnë këtë më së miri.

Por, ka një çështje tjetër dhe kjo është se përveç këtyre dy klasave, ne duhet të kërkojmë edhe një grup. Siç e kemi parë, ka në çdo epokë gjeni dhe njerëz të veçantë, njerëz që janë të detyruar të vendosen në majën më të lartë të konit. Nga pikëpamja e shkollimit dhe stilit të menduarit, fjalët e tyre mbizotërojnë përmbi mendimin e kohës të njerëzve të arsimuar. Numri i këtyre njerëzve rritet në fund të çdo ere. Të njohur qartë siç ishin Johannes Kepler, Isaac Newton, Francis Bacon dhe Roger Bacon, që i dhanë formë opinionëve të njerëzve të epokës së tyre, ata marrin fuqi e forcë dhe formulojnë stilin e menduarit të intelektualëve të së ardhmes. Këta individë që tani ndodhen në majën e konit do të formojnë njerëzit e mësuar të së ardhmes sipas atij ligji determinizmi që përmenda më lart.

Kështu, sipas kësaj metode, ne mund t'i hedhim një sy historisë të së ardhmes. Si? Nëse i njohim këta gjeni të tanishëm që janë në kulmin e konit dhe atë se si ata mendojnë e nëse mund t'ju paraqes juve ata që ndodhen në majën e konit tani e t'ju tregoj se si mendimet e këtyre gjenive u kundërvihen metodave të mendimit të adhurimit të shkencës nga të shkolluarit e tre shekujve të fundit, atëherë ne mund ta zgjidhim problemin që përmenda. Ne mund të parashikojmë qartë se si do të mendojë klasa e mësuar e së ardhmes në epokën që do pasojë të tanishmen, dhe çfarë prirjesh, bindjesh dhe ndjenjash do të kenë ata. Jemi të detyruar t'i vendosim gjenitë e njerëzimit sot përmbi klasën e shkolluar sepse, nga njëra anë, njerëzit e shkolluar i konsiderojnë ata të mbi-shkolluar, dhe nga ana tjetër, jemi të detyruar të mos i vendosim ata midis njerëzve të shkolluar të së sotmes sepse ata mendojnë dhe flasin ndryshe nga ky grup.

Një gjeni i tillë është Guénon. Libri i tij "Krizë e Botës Moderne" dhe revista e tij e studimeve fetare janë botuar në Evropë. Ai është një gjeni i madh dhe dijetar francez që papritur revoltoi kundër shkencës dhe adhurimit të saj, shkoi në Lindje e u tërhoq në Egjipt - jo një tërheqje në kuptimin e sotëm të fjalës, por përkundrazi ai u largua nga shoqëria dhe mënyra e menduarit të së sotmes, me qëllim që t'i përgjigjej nevojës dhe etjes së madhe të popujve të Evropës. Një tjetër ishte Alexis Carrel. Një ndër veprat e tij më të famshme është "L'homme cet inconnu", që është përkthyer në persisht megjithë disa vepra të tjera të tij. Ai ka shkruar një tjetër libër të quajtur "Meditimi im i Pilgrimazhit të Lourdesit". Një tjetër është "Le Cont de Louis". Ai shkroi "Fatin e Njerëzimit", botuar dy herë në persisht. Përkthimi është i keq, por teksti ia vlen të studiohet. Pastaj është Einstein, William James apo Gaston Bachelard, që është mendimtari-filosof më i madh francez dhe përbën shumë më tepër nga ç' shohin njerëzit e botës sot te Jean-Paul Sartre dhe Bertrand Russell. Janë gjithashtu Max Planck, Georges Gurvitch, Patrick Donitz e Boris Pasternak, që shkroi "Dr. Zhivago". Këta njerëz s'mund të vihen kurrë në klasën e të shkolluarve të rinj, por mund të ndodhen vetëm në kulmin e konit, sepse në përgjithësi ata i kundërvihen adhurimit të shkencës. Ata flasin kundër tij dhe fesë së shkollarëve të tre shekujve të fundit. Natyrisht, s'mund të thuhet se Guénon flet tamam si Max Planck dhe se Max Planck përsërit fjalët e Alexis Carrelit. Secili ka një këndvështrim të ri. Por ekziston diçka e përbashkët. Pra, nëse gjejmë një parim të përbashkët, mund të dallojmë, me anë të metodës që përmenda, se ky parim i përbashkët është një prirje e re që shihet në botë, një solidaritet në të kundërshtuarit e tendencës së përgjithshme të adhurimit të shkencës e cila është feja e intelektualit të sotëm. Kjo prirje e re në erën e ardhshme do të shndërrohet në fenë e intelektualit të larmisë të së ardhmes dhe do e zëvendësojë adhurimin e shkencës që

përbën fenë e njerëzve të shkolluar të sotshëm. Në të gjithë këta njerëz të jashtëzakonshëm mbizotëron një ide - ajo është ndjenja religjioze dhe besimi në përsëritshmëri që ata e kanë të përbashkët, pa përjashtim. Fatkeqsisht, nuk kemi kohë të citojmë secilin prej tyre.

Mund të pohojmë se Einstein kishte ndjenja të mëdha religjioze. Por në thamë se feja është baza e bindjeve të njerëzve të thjeshtë! A mund të themi se Einstein është midis njerëzve të thjeshtë dhe atyre që kanë një diplomë të shkollës së mesme apo një gradë universiteti ose një inxhinier apo një Doktor i Filosofisë siç jam vetë dhe ndodhet kështu në klasën e të shkolluarve të rinj? Kurrë! Prapëseprapë ai është fetar. Kështu, bëhet e qartë se përveç adhurimit të shkencës, po shfaqet një mendim i ri në botë që përbën valën më të madhe të mendimit sot. S'mund të themi kurrë se feja e Einsteinit apo Carrelit është e lëndës së njëjtë me atë të popullit të thjeshtë. Ajo është një fé që ndodhet përmbi bindjet e intelektualëve, përmbi shkencën. Kështu, ekzistojnë dy fé. Njëra është ajo së cilës i mungon shkollimi e shkenca - është kjo fé që ekziston në fundin e konit model. Tek ngjitemi niveleve të fesë, arrijmë një ateizëm shkencor në erën tonë dhe nëse ngjitemi më lart, arrijmë një meta-fé. Kjo mund të shihet qartë në botën e sotme.

Shikojini të shkolluarit. Dikush është i shkolluar por feja e tij merret nga poshtë dhe ai e tërheq përgjatë atë me vete si pjesë rezervë. Ai është bërë një inxhinier apo doktor dhe e ka mbajtur fenë e tij. Ai e mori atë nga masat dhe e tërhoqi zvarrë me vete. Kjo është jonormale dhe duhet flakur tej. Nëse atij i mungon feja, për mendimin tim, ai ndodhet më pranë një feje të meta-shkencës e cila qëndron përmbi dhe (shtrihet) përtej shkencës. Përsëri pastaj kemi një person të shkolluar që është fetar dhe shohim si ndjek ai një fé që ndodhet përmbi shkencën. Kjo është e qartë nga ajo që shkruan ai. Kjo fé mund të vërehet te njerëzit, universitetet, te mendimet. Kjo fé që është më pak se shkenca qëndron më poshtë se njerëzit e shkolluar dhe feja që ndodhet përmbi shkencën e cila s'i ka arritur lartësitë e kësaj, është një fé që e kanë mbërritur mendimtarët e mëdhenj të botës që përmenda dhe të cilët bota i njeh. Këta njerëz qëndrojnë mbi të shkolluarit. Ata janë gjenitë e rinj. Shumë nga fjalët që ne kemi në Kur'an apo (mendimet) që i kemi përfutur duke iu përmbajtur Kur'anit nga afër, i dëgjojmë papritur në një përkthim ose një tekst nga Max Planck, Einstein apo Carrel.

Shumica e këtyre njerëzve që përmenda kaluan përmes një kohe krize, një kohe ateizmi dhe pastaj një rigjetje, rizbulim të fesë përmbi dhe përtej shkencës. Të gjithë ata janë mes njerëzve më të shquar dhe mirë-shkolluar që kundërshtuan dhe u revoltuan kundër adhurimit të shkencës. Përzgjedhja e tyre e përbashkët është kthimi i përsëritshmërisë; kthimi i ndjenjave dhe ndijshmërive fetare. Gjatë tre shekujve të fundit njerëzit janë abuzuar dhe dënuar nga idea se feja është besimi i njerëzve të thjeshtë dhe se (si e tillë) duhet lënë mënjanë. Kështu, ajo në të cilën duhet të besojmë është se sot, si në shek. XVI, kur u shfaqën gjenitë që sollën adhurimin e shkencës, kanë dalur gjithashtu gjenitë që nuk përputhen me klasën e tanishme të shkollarëve. Fjalët e tyre nuk janë njohur (pranuar) ende zyrtarisht. Ata nuk janë përvetësuar në universitet; megjithatë ata flasin përmbi nivelin e universitetit. Mesiguri, mendimet dhe fjalimet e këtyre njerëzve formojnë themelin e besimit të njerëzve të shkolluar të së ardhmes, të cilëve ata do t'i japin trajtë gjatë periudhës së nesërme historike. Kështu, padyshim feja e sotme është një kthim te feja që ndodhet përmbi shkencën, d.m.th e vërteta e fesë. Pra, gjatë historisë mund të thuhet që ne besojmë se sot era e adhurimit të shkencës nga klasa e mësuar e formuar në shek. XVII, që çoi në përhuajtjen nga feja, po merr fund. Përse? Sepse tanimë kanë dalë gjenitë që ndodhen mbi shkencën e së sotmes dhe që njoftojnë një

besim në një Shpirt dhe Intelekt të Madh në gjithësi dhe nevojën e njerëzimit për të adhuruar apo patur besim fetar.

Nëse një njeri është fizikan si Max Planck, ai flet kështu: "Kepleri ishte një dijetar që besonte në një sistem tërësisht të mençur, plotësisht të ndërgjegjshëm dhe krejt të vetëdijshëm për të gjithë krijimin". Ai gjithashtu jep një dijetar tjetër si shembull (Tycho Brahen – sh.p) dhe thotë: "Ai nuk kishte një besim të tillë në një sistem total të gjithësisë si dhe një intelekt suprem që ekziston dhe për këtë arsye, ai mbeti në nivelin e një studiuesi të vogël eksperimental. Ai mbeti në këtë nivel sepse nuk besonte në një intelekt universal, ndërsa Kepleri besonte në të dhe prandaj ai u bë themeluesi i fizikës së re." Ja pra si flet ai. Einstein, në të njëjtën fushë thotë: "Ndjenja religjioze dhe besimi në një sekret të madh në Krijim, është një koncept thelbësor në kërkimin e madh shkencor." Një psikolog (W. James – sh.p) flet në një mënyrë tjetër. Ai thotë: "Në fatin e njerëzimit, lutja është e nevojshme, adhurimi është i domosdoshëm porsì nevoja për ushqim dhe për ajër; ajo është një nevojë e natyrshme. Nëse në vetvete jemi të verbër ndaj nevojës për adhurim, ne do të shkatërrohemi." Një njeri si Carrel, i cili nuk qe kurrë fetar dhe që mori dy Çmime Nobel për kërkimet që kreu në zemrat e trumcakëve dhe transplantimin e tyre, thotë: "Të adhuruarit është si të marrurit frymë e të ngrënit dhe është pjesë e nevojës sonë më të natyrshme fizike, neurologjike, psikologjike dhe intelektuale." Ai vazhdon: "Nga mungesa e një besimi të fortë ne fé, Roma u shkatërrua." Këto janë fjalë të Alexis Carrel, jo të një prifti, jo të një personi fetar në bazën e konit. Alexis Carrel është njeriu i parë që mori dy Çmime Nobel për shkencën dhe sipas fjalorit Larousse, ai ishte një person i shquar, mendimi i të cilit pati një ndikim të madh përgjatë shekullit XX. Ai pohon: "Nëse adhurimi, lutja e Krijuesit të Dashur, i hiqet shoqërisë, ne kemi firmosur çertifikatën e vdekjes së asaj shoqërie."

A flitnin kështu njerëzit e shkolluar të shekujve XVII, XVIII dhe XIX? Ata thonin: "Nëse unë s'mund ta shoh Zotin nën bisturi, nuk do ta besoj Atë". Adhuresit e shkencës flitnin kështu. Por sot, siç thotë Gurvitch, (është ndryshe): "Në shek. XIX, sociologjia miratoi 198 ligje në të cilat besoi, por sociologjia në shek. XX s'beson në asnjë ligj". Laurent Schwartz, matematikani më i madh francez thotë: "Fizika në shek. e XIX besonte se mund të shpjegonte të gjitha çështjet e jetës, edhe poezinë madje, ndërsa sot fizika beson se nuk mund të arrijë të njohë as se ç'është materia". Pse është bërë kaq modeste shkenca në shek. e XX sipas Gurvitchit dhe pse krenaria e shekujve të XVI, XVII, XVIII dhe XIX është thyer copash? Sepse një erë e re po zë fill në botë. Shkolla e mendimit të njerëzve të ditur të së ardhmes, në ndryshim me të mësuarit e të sotmes, do të jetë një shkollë religjioze mendimi, një fé jo më e ulët se shkenca, por përkundrazi - më e lartë se ajo.

*Përktheu: Edin Q. Lohja,  
Maj 2000*